



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:005454
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05766056

KPPP.nr.1860/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Limak Kosovo International Airport- Sh.A. "Adem Jashari" (tutje si LKIA) me seli në Vrellë - Lipjan, me NRB: 70676508, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit SH.S. dhe L.F. kundër debitorit "Paper Communication" Sh.p.k., me NRB:70549557, me seli në Prishtinë, rruga "Mujo Ulqinaku" nr.12, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Ardi Shita dhe Atdhe Dika me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.585/21 të datës 23.12.2021 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Paper Communication" Sh.p.k, ANULOHET Urdhri Përmbartimor .nr.585/21 të datës 23.12.2021 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor nr.585/21 të datës 23.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – Fatura 60000002087 të datës 31.03.2021 ku e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 61,950.00 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke llogaritur nga data kur kredia është bere e arritshme, e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetimin se faturat e bashkangjitura në propozim nuk janë të pranuar, respektivisht nuk janë të nënshkruara e as të vulosura dhe se e njëjta është lëshuar në formë të njëanshme. Tutje ka shtuar se përshkrimi i shërbimit në fatura është i paqartë dhe në asnjë pikë të vetme nuk i referohet kontratës të lidhur mes palëve, dhe se fatura dhe komunikimi nuk janë në gjuhë zyrtare, pos tjerash i ka i propozuar Gjykatës ta pranoj në tërësi si të bazuar prapësimin si dhe ta anuloj urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se debitori asnjëherë nuk e ka mohuar borxhin të cilin e ka ndaj kreditorit si dhe është zotuar përmes telefonit dhe komunikimeve me postë elektronike se do ta përmbush obligimin e tij. Tutje thekson se ka paraqitur tërheqjen nga propozimi për përmbarim pas premtiveve të debitorit për realizimin e borxhit të cilat nuk u përfillën, andaj duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta hedh poshtë prapësimin si të pa bazuar si dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas nenit 17 të LPP-së, përcaktohet se *“Në procedurën përbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, lidhur me nenin 331.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore në të cilin përcakton se *“Çdo palë ndërgjyqëse detyrohet kryesisht të paraqesë shkresat që ka përdorur për të provuar thëniet e veta”* dhe 331.2 *Së bashku me shkresën e hartuar në gjuhë të huaj paraqitet edhe përkthimi i legalizuar nga ana e përkthyesit gjyqësor të përhershëm.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekura në bazë të cilave është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29, 37, 17 të LPP-së lidhur me nenin 331 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Në shkresat e lëndës gjykata gjeti se dokumenti – fatura në bazë të cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokumente i besueshme, për faktin se fatura dokument përbarimor, mbi bazën e së cilës është lëshuar urdhri përbarimor, është në gjuhë të huaj dhe e njëjta nuk është e përkthyer në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të përcaktuara sipas dispozitave ligjore, .

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokument i besueshme, mbi të cilat mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet, në shkresat e lëndës ishte e përkthyer vetëm kontrata e nën koncesionit, por sipas propozimit për përbarim dokumenti përbarimor nuk është kontrata, por fatura me numër 60000002087 të datës 31.03.2021.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përbarimore, pasi që dokumenti përbarimor mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përbarimor është në gjuhë të huaj, i njëjti nuk ishte i përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare, andaj në pamundësi të vlerësimit të dokumentit përbarimor, pretendime tjera mbeten të pa shqyrtuara.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1860/22, datë 31.05.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.